

Ecuria e zbatimit të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë

Në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2024”, Kuvendi i Shqipërisë i kërkoi Komisionerit që gjatë vitit 2025 të përqendrojë veprimtarinë në disa drejtime prioritare, të cilat lidhen me forcimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, rritjen e transparencës, përmirësimin e mbikëqyrjes dhe rritjen e profesionalizmit të administratës publike. Këto drejtime përfshijnë intensifikimin e inspektimeve në nivel vendor, zhvillimin e mekanizmave të monitorimit në kohë reale, digjitalizimin e komunikimit me publikun, bashkëpunimin për zbatimin e vendimeve gjyqësore, monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë periudhave zgjedhore, evidentimin e institucioneve me shkelje të përsëritura dhe analizimin e kostove financiare që burojnë nga emërimet e paligjshme dhe vendimet gjyqësore të paekzekutuara.

Duke marrë në konsideratë këto kërkesa, Komisioneri e ka orientuar veprimtarinë e tij përgjatë vitit 2025 drejt disa objektivave strategjike që synojnë forcimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e efikasitetit institucional. Megjithëse rezoluta e Kuvendit është miratuar në muajin nëntor 2025, Komisioneri ka filluar menjëherë procesin e përshtatjes së planeve dhe procedurave të nisura të mbikëqyrjes me detyrimet e reja të përcaktuara në këtë akt.

Në vijim, për secilën pike të rezolutës së Kuvendit paraqiten veprimet konkrete të ndërmarra gjatë periudhës raportuese dhe rezultatet e arritura, me qëllim ofrimin e një pasqyre të plotë mbi nivelin e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara.

1. Të intensifikohen inspektimet në njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke i dhënë përparësi atyre me shkelje të përsëritura të procedurave të shërbimit civil.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri ka forcuar kontrollin dhe inspektimin në njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke u bazuar në indikatorë risku. Në këtë kuadër, me urdhër të Komisionerit dhe përmes përditësimit të planit vjetor të punës, janë shtuar 5 inspektime të thelluara në 4 bashki dhe 1 prefekturë qarku, lidhur me procedurat e konkurrimit dhe procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë.

Në vijim të kësaj qasjeje, në planin vjetor të punës për vitin 2026 janë parashikuar edhe 6 inspektime të tjera të thelluara në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Kjo detyrë e rezolutës është zbatuar plotësisht.

2. Të zhvillohen mekanizma për monitorim të vazhdueshëm dhe në kohë reale për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nivel vendor.

Një tjetër drejtim pune gjatë vitit 2025 ka qenë ngritja e mekanizmave për monitorimin e vazhdueshëm dhe në kohë reale të zbatimit të ligjit “Për nëpunësin civil”, veçanërisht në nivel vendor. Në këtë kuadër, janë zhvilluar diskutime me Departamentin e Administratës Publike dhe AKSHI-n për mundësimin e aksesit të Komisionerit në Regjistrin Qendror të Personelit dhe platformën CONLAD, me synim përmirësimin e mbikëqyrjes institucionale dhe shfrytëzimin më efikas të të dhënave ekzistuese.

Paralelisht, është punuar për konceptimin e një platforme digjitale që do të mundësojë mbledhjen dhe analizimin automatik të të dhënave nga institucionet publike mbi proceset e rekrutimit, vlerësimit të performancës, masave disiplinore dhe elementë të tjerë të administrimit të shërbimit civil. Kjo platformë synon të mbështesë identifikimin në kohë të institucioneve me risk më të lartë, përmirësimin e planifikimit të inspektimeve dhe forcimin e transparencës në zbatimin e legjislacionit.

Kjo ide është zhvilluar më tej në fillim të vitit 2026, përmes konsultimeve teknike dhe aktualisht po punohet në vazhdimësi për konkretizimin e saj, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, ndërsa ecuria dhe rezultatet e këtij procesi do të pasqyrohen në raportin për vitin 2026.

Kjo detyrë e rezolutës është në proces.

3. Me qëllim përmirësimin e transparencës dhe komunikimit publik KMSHC të zhvillojë platformat digjitale për raportim dhe ankim nga nëpunësit civil dhe qytetarët për shkelje të procedurave.

Gjatë vitit 2025 është punuar për përmirësimin e transparencës dhe komunikimit publik përmes zhvillimit të mjeteve digjitale të informimit dhe raportimit. Në faqen zyrtare të institucionit është krijuar një rubrikë e posaçme ku nëpunësit civilë dhe qytetarët mund të paraqesin kërkesa apo informacione lidhur me administrimin e shërbimit civil, ndërkohë që është intensifikuar edhe përditësimi në kohë reale i veprimtarisë së institucionit. Me ardhjen në detyrë të Komisionerit të ri ka filluar gjithashtu puna për krijimin dhe aktivizimin e platformave në rrjetet sociale, me qëllim rritjen e ndërveprimit me publikun.

Aktualisht, Komisioneri po bashkëpunon me AKSHI-n dhe një sërë aktorësh të tjerë vendas apo të huaj për të shqyrtuar mundësitë e shtrirjes së mëtejshme të digjitalizimit në proceset e institucionit, në funksion të lehtësimit të raportimit dhe përpunimit të informacionit nga nëpunësit civilë dhe qytetarët.

Në lidhje me termin “ankim”, sqarojmë se, ndonëse Komisioneri nuk ka kompetencë të drejtpërdrejtë për shqyrtimin e ankesave individuale, ai ka trajtuar dhe verifikuar të gjitha kërkesat dhe denoncimet e paraqitura, në kuadër të kompetencave të tij mbikëqyrëse, duke dhënë përgjigje konkrete ose duke ndërmarrë masa paralajmëruese ndaj institucioneve përkatëse. Aktualisht, në

kuadër të ndryshimeve të propozuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të cilat janë në fazën e konsultimit publik, Komisioneri ka përgatitur disa propozime konkrete në lidhje me këtë aspekt, të cilat do t’i paraqiten Kuvendit në raportin vjetor të veprimtarisë.

Kjo detyrë e rezolutës është në proces.

4. Në bashkëpunim të ngushtë me DAP, të intensifikojë angazhimin në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore për rikthim në detyrë të nëpunësve civilë.

Gjatë vitit 2025, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, Komisioneri ka intensifikuar veprimtarinë në lidhje me monitorimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë. Me Vendimin nr. 22, datë 21.05.2025, është zhvilluar një proces i orientuar mbikëqyrjeje për mbledhjen dhe analizimin e informacionit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në kuadër të të cilit janë administruar të dhëna nga 61 bashki dhe 12 këshilla qarku. Procesi është përmbyllur në fillim të vitit 2026 me miratimin e raportit të vlerësimit.

Paralelisht, gjatë vitit 2025 Komisioneri ka ofruar asistencë teknike në 27 institucione të vetëqeverisjes vendore mbi procedurat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe trajtimin e proceseve disiplinore, si edhe ka trajtuar kërkesa për mendim të specializuar nga institucione publike, nëpunës civilë dhe përmbaues gjyqësorë në rastet e moszbatimit të këtyre vendimeve.

Këto veprime kanë synuar përmirësimin e praktikave institucionale dhe forcimin e zbatimit të legjislationit në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë.

Kjo detyrë e rezolutës është zbatuar plotësisht.

5. Të hartojë një raport të posaçëm me gjetjet nga monitorimi i sjelljes së nëpunësve civil gjatë periudhës zgjedhore për vitin 2025 dhe të informojë Komisionin për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike në lidhje me gjetjet e këtij monitorimi.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri zhvilloi procesin e monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, me qëllim garantimin e paanshmërisë politike të administratës publike. Në këtë kuadër, në fillim të vitit u hartua një udhëzues për unifikimin e praktikave administrative gjatë periudhës zgjedhore dhe u miratuan instrumente standarde raportimi, duke ngritur njëkohësisht grupe monitorimi në institucionet e përfshira në sistemin e shërbimit civil.

Procesi përfshiu komunikimin me rreth 200 institucione të administratës publike dhe monitorimin e mbi 13 600 pozicioneve të shërbimit civil, si dhe realizimin e inspektimeve të drejtpërdrejta në

institucione të përzgjedhura. Gjatë kësaj periudhe nuk u konstatuan emëtime të reja në shërbimin civil me karakter të dyshuar politik dhe u respektuan procedurat ligjore për pjesëmarrjen e nëpunësve civilë në procesin zgjedhor. Janë trajtuar gjithashtu disa raste denoncimesh dhe mungesash në punë, për të cilat institucionet përkatëse kanë ndërmarrë masa administrative ose disiplinore sipas legjislacionit në fuqi.

Në përfundim të monitorimit është hartuar një raport vlerësimi me gjetjet përkatëse, i cili është përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke përmbushur detyrimin për informim dhe llogaridhënie.

Kjo detyrë e rezolutës është zbatuar plotësisht.

6. Të investohet në hartimin e një raporti vjetor me listimin e institucioneve me shkelje të përsëritura dhe propozime për ndërhyrje nga institucionet mbikëqyrëse.

Në zbatim të detyrës së lënë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe në vijimësi të përpjekjeve për forcimin e llogaridhënies, gjatë vitit 2025, Komisioneri ka filluar punën për hartimin e një raporti vjetor që do të evidentojë institucionet me shkelje të përsëritura të ligjit për shërbimin civil.

Ky raport do të mbështetet në një bazë të dhënash mbi rastet e konstatuara ndër vite dhe do të përfshijë analiza statistikore mbi natyrën dhe shpeshësinë e shkeljeve.

Kjo detyrë e rezolutës është në proces.

7. Të angazhohet në hartimin e një raporti analitik në lidhje me kostot financiare për buxhetin e shtetit në rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin si dhe në lidhje me vendimet gjyqësore të paekzekutuara.

Në lidhje me hartimin e një raporti analitik mbi kostot financiare për buxhetin e shtetit që burojnë nga emërimet në kundërshtim me ligjin dhe nga vendimet gjyqësore të paekzekutuara, Komisioneri ka nisur procesin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse. Në këtë kuadër janë dërguar kërkesa zyrtare për informacion pranë ministrive të linjës, Departamentit të Administratës Publike dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore, me qëllim evidentimin e detyrimeve financiare të krijuara nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe rastet e emërimeve të paligjshme.

Institucioneve u është kërkuar të përcjellin të dhëna mbi listat e pritjes së nëpunësve gjyqfitues, vlerën e detyrimeve monetare të paguara dhe të papaguara, arsyet e vonesave në ekzekutim dhe mundësitë për sistemimin e menjëhershëm të tyre në strukturat organike. Paralelisht, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike është kërkuar rishqyrtimi i mundësive për sistemimin e nëpunësve civilë gjyqfitues, me mbikëqyrjen e përfaqësuesve të Komisionerit.

Ky proces vijon edhe gjatë vitit 2026, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Departamentin e Administratës Publike dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit, me synim hartimin e një raporti të plotë analitik që do të evidentojë ndikimin financiar në buxhetin e shtetit nga këto raste.

Kjo detyrë e rezolutës është në proces.